

NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfeket



Pamje dhe fjalë nga Emilia Romagna, 1

Regione Emilia-Romagna

Servizio Comunicazione, Educazione alla Sostenibilità

Responsabile Paolo Tamburini

Agenzia Informazione e ufficio Stampa della Giunta

Direttore Roberto Franchini

www.regione.emilia-romagna.it

Istituto per i Beni Artistici Culturali e Naturali

Presidente Ezio Raimondi

Direttore Alessandro Zucchini

www.ibc.regione.emilia-romagna.it

Consulta degli Emiliano-Romagnoli nel mondo

Presidente Silvia Bartolini

www.emilianoromagnolinelmondo.it

Coordinamento editoriale

Tiziana Gardini

Piera Raimondi

Agenzia Informazione e ufficio Stampa della Giunta

Illustrazioni

Sergio Tisselli

Impaginazione

Monica Chili

Traduzioni

Logos Group, Modena

Progetto e coordinamento del gruppo

Valeria Cicala

Vittorio Ferorelli

Istituto per i Beni Artistici Culturali e Naturali

Gina Pietrantonio

Servizio Comunicazione; Educazione alla Sostenibilità

Gruppo di lavoro

Paolo Degli Esposti

Silvia Mazzoli

Simonetta Trevisi

Servizio Comunicazione; Educazione alla Sostenibilità

Sante Zavattini

Servizio Affari Generali, Giuridici e Programmazione Finanziaria

Claudio Bacilieri

Katia Guizzardi

Rita Tagliati

Servizio Politiche europee e relazioni internazionali

Andrea Facchini

Servizio Politiche per l'accoglienza e l'integrazione sociale

Elena Rossi

Servizio Programmazione, valutazione e interventi regionali

Stefania Sani

Servizio Turismo e Qualità Aree Turistiche

Cinzia Leoni

Barbara Musiani

Agenzia Informazione e ufficio Stampa della Giunta

Morena Grandi

Catia Luccarini

Cristina Turchi

Servizio Cultura, Sport e Progetto Giovani

Laura Grossi

Servizio Lavoro

NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfeket



Nëntë hapa nëpër histori lind nga bashkëpunimi mes shumë drejtorive rajonale, me objektivin për të prezantuar Emilia-Romagna-n, duke e përcjellë historinë e saj me fjalë të thjeshta, të pikturuar artistikisht me akualet nga Sergio Tisselli.

Për ata që shfletojnë këtë broshurë, mesazhi është që kjo tokë ka pritur gjithmonë njerëz dhe përvoja të ndryshme, të cilët kanë formësuar fizionominë e një territori, ku si deti ashtu edhe lumi dhe si rruga ashtu edhe qafa e Apeninit kanë qenë mjete lidhëse, shkëmbimi ekonomik dhe zhvillimi kulturor.

Të kuptuarit e identitetit të Emilia-Romagna-s është një mënyrë për t'ua përcjellë të tjerëve, për të hyrë në një marrëdhënie të veçantë me ata që nuk jetojnë më këtu por rrënjët e të cilëve janë në këtë tokë, dhe me ata që shpërngulen këtu në kërkim të mundësive të reja.

Ky rajon, si i tillë, i afrohet një date të rëndësishme për ekzistencën e saj: dyzet vjet nga lindja zyrtare e themelimit rajonal, një moshë që na bën të mendojmë për gjithçka që ka që ka bërë për t'u garantuar zhvillimin banorëve të saj, për projektet dhe strategjitë e së ardhmes. Ky botim i përmbledhur ka për qëllim ndërgjegjësimin për pasuritë mbi të cilat shtrihet realiteti ynë i rëndësishëm dhe përgjegjësinë me të cilën duhet t'i administrojmë ato.

Vasco Errani

President i rajonit Emilia-Romagna


Ekziston një fjalë e bukur në anglisht, *serendipity*, që shpreh mundësinë për të zbuluar rastësisht gjëra të këndshme dhe të papritura, për të gjetur diçka krejt rastësisht. Ndodh edhe gjatë kontakteve të Këshillit të emilio-romanjolëve nëpër botë me shoqatat dhe komunitetet bashkëvendëse jashtë shtetit, që të ndeshen me histori dhe situata që hapin papritur dimensione të reja: gjurmë të pazbuluara të pranisë së emilio-romanjolëve përtej Oqeanit, në skajin tjetër, në territore të largëta, drejt të cilave i çoi nevoja për të mbijetuar ose dëshira për aventura të reja.

Ekziston një fenomen i përhapur veçanërisht mes të rinjve, që ka të bëjë me serendipitetin, edhe pse në këtë rast zbulimi nuk është rastësor, por i kërkuar. Bëhet fjalë për zakonin, që e ka origjinën në Shtetet e Bashkuara dhe ka ardhur deri tek ne, e të lënit të librave në ambiente natyrore ose nëpër qytet, derisa të gjenden e të lexohen nga njerëz të tjerë. Është një lloj *bookcrossing*, ose "përcjellje libri" që përbën një grip narrativ të *Nëntë hapa nëpër histori*, botimi që Këshilli u ofron komuniteteve të emiliano-romanjolëve jashtë shtetit, për t'i prezantuar ata me historinë dhe kulturën e këtij territori rajonal. Njëherë, një vajzë afrohet pranë kullave të këtij rajoni për një takim dhe mbi një mur të vogël sheh një libër të harruar ose të lënë aty enkas nga dikush; fillon ta shfletojë dhe lexon një histori: historinë e një skaji të botës, të Emilia-Romagna-s. Pamjet që shpalosen nga karikaturisti dhe akvarelisti Sergio Tisselli, do t'u mundësojnë miqve tanë të largët të ndalen në çështjet mijëvjeçare të rajonit tonë dhe t'i ndiejnë ato disi pjesë të tyre. Në një farë mënyre, këto janë çështje familjare që i përkasin gjithë komunitetit tonë në Itali dhe jashtë saj.


Ideja e kësaj dhurate që ju bëjmë me rastin e dyzet vjetorit të rajonit Emilia-Romagna ka lindur nga bashkëpunimi midis Këshillit, Agjencisë së informacionit dhe zyrës së shtypit të Këshillit, Zyrës rajonale të marrëdhënieve me publikun dhe Institutit të pasurive kulturore, të cilat po punojnë së bashku për rinovimin e faqes së internetit *Emilianoromagnolinelmondo.it* ku në seksionin "Storia e cultura in Emilia-Romagna" ("Historia dhe kultura në Emilia-Romagna") mund të gjeni materialet që kemi mbledhur dhe pasuruar me pamje poetike për këtë botim.

Silvia Bartolini

Presidente e Këshillit
të emiliano-romanjolëve nëpër botë



JA KULLAT E RAJONIT:
MBËRRITA!
E MADJE PARA KOHE...



PO KY LIBËR?
Ç'ËSHTË?



**NËNTË HAPA
NËPËR HISTORI**
Emilia-Romagna rrëfëhet



ADRIATIKU,
DETI QË ...

MIDIS SHEKUJVE XVII DHE XVI
PARA KRISHTIT, NË EPOKËN E BRONXIT, NË
KËTË TOKË U PËRHAP NJË QYTETËRIM QË MERR
EMRIN NGA "TERRAMARE" (TROJE ARKEOLOGJIKE,
FSHATRA E NDËRTUAR MBI PALAFITA (SHTYLLA TË
NGËLLURA): KJO KULTURË PRIMITIVE, QË I PËRKISTE SHUMË
ZONAVE TË EMILIA-ROMAGNA DHE ARRINTE MADJE EDHE
ZONAT E AFËRTA TË APENINIT, KA LËNË DËSHMI TË
PASURA NË TERRITORET E MODENA-S DHE
PARMA-S.





NËNTË HAPA NËPËR HISTORI


Emilia-Romagna rrëfëhet

Adriatiku, deti që në lindje shënon kufirin e Emilia-Romagna-s, frekuentohej që në periudhën parahistorike. Popujt që zbarkuan e më pas u vendosën në këtë gadishull italian lanë gjurmët e tyre në këtë territor dhe në rrëfimet e shkrimtarëve antikë.

Midis shekujve XVII dhe XVI para Erës së Re, në epokën e Bronxit, në këtë tokë u përhap një qytetërim që merr emrin nga "terramare" (troje arkeologjike), fshatrat e ndërtuar mbi palafita (shtylla të ngulura): kjo kulturë primitive, që i përkiste shumë zonave të Emilia-Romagna-s dhe arrinte madje edhe zonat e afërta të Apeninit, ka lënë dëshmi të pasura në territoret e Modenës dhe Parmës.


Deti Adriatik përmendet edhe në mitologjinë greke, si tek Herkuli dhe në rrëfenjat e heronjve homerikë.

Që prej shekullit VII para Krishtit, lundrimet greke filluan të intensifikoheshin: një pjesë e mirë e tyre i drejtoheshin deltës së lumit Po, e veçanërisht në Spina, sikurse dëshmojnë qeramikat e mrekullueshme që sot janë ekspozuar në muzeun arkeologjik të Ferrara-s. Gjatë gjithë periudhës antike, kjo portë e ruajti funksionin e saj si një treg lumor drejt Padanias dhe Apleve, pra drejt Evropës.





“Protovillanovian” dhe “Villanovian” janë termat që përdoren sot për të përcaktuar kulturat që gjatë shekujve VIII dhe VI para Krishtit shënuan edhe në këtë rajon pikëpikë me qytetërimin etrusk. Etruskët që vinin nga lugina e Renos përmes qyteteve të Marzabotto-s dhe Bologna-s (që në atë kohë quhej *Felsina*), takoheshin edhe në deltën e lumit Po. Nga Apeninet e deri këtu, principatat dhe qytetet e ndryshme etruske dominonin në tregti veçanërisht në pjesën lindore të rajonit, si për shembull përmes luginës së Marecchia-s, ku mbi një qendër të lulëzuar protovillanoviane, ngrihej pika e banimit e Verucchios. Në pjesën perëndimore, dominimi etrusk qe një monopol i vërtetë politik, si në *Felsina*, përgjatë rrugës për në Spinë, ashtu edhe në zonën e Modena-s, në atë të Parma-s, të Piacenza-s e madje edhe përtej lumit Po. Nga kjo u zhvillua një prodhimtari e vërtetë artistike dhe një kulturë e rafinuar qytetare, si në qytetin e themeluar në Marzabotto, në luginën e Renos. Në Apeninin perëndimor, kultura etruske u ndesh dhe u ndërthur me atë të popujve ligurianë që ishin vendosur aty, por që më vonë u njohën me pushtimin keltik dhe me ardhjen e mëpasme të romakëve.



Në Emilia-Romagna, keltët u vendosën nëpër fshatrat ku zakonisht dominonin lugajat e Apenineve: si në Monte Bibele, në luginën bolonjeze të Idices. Për t’iu rikthyer detit, bregdeti Adriatik vazhdoi të rrihej nga



QË PREJ SHEKULLIT VII PARA KRISHTIT, LÛNDRIMET GREKE FILLUAN TË INTENSIFIKOHESHIN: NJË PJESË E MIRË E TYRE LÛNDRONIN DREJT DELTËS SË LUMIT PO, E VEÇANËRISHT NË SPINA, SIKURSE DËSHMOJNË QERAMIKAT E MREKULLUESHME QË SOT JANË EKSPOZUAR NË MUZELIN ARKEOLOGJIK TË FERRARA-S. GJATË GJITHË PERIUDHËS ANTIKE, KJO PORTË E RUAJTI FUNKSIONIN E SAJ TË NJË TREGU LUMOR DREJT PADANIAS DHE APLEVE, PRA DREJT EUROPËS.





NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfëhet

lundrimet bregdetase: vendankorimet kryesore ishin Rimini dhe Ravenna; nga *Ariminum* (që do të thotë Rimini, kolonia e parë e krijuar nga Roma në zonën e lumit Po, në vitin 268 para Krishtit) njerëz dhe mallra zbrisnin në luginën e Tevere-s përmes luginave apenine. Në epokën romake, lugina e lumit Po quhej Gallia Cisalpina: thënë ndryshe, toka e galëve e rrethuar nga harku alpin. Në

brendësi të tij, rrjedha e lumit Po (nga latinishtja

Padus), identifikonte dy rajone: *Transpadana-n*

dhe *Cispadana-n* (që është Emilia-Romagna e sotme). Themelimi i Rimini-t përgatiti hyrjen

e romakëve: në vitin 218 u themelua

kolonia e *Placentia-s* (Piacenza e sotme).

Lufta e dytë punike dhe Anibali arritën

ta ndalojnë për vite me radhë zgjerimin

romak në këtë rajon. Midis viteve 189

dhe 183 para Krishtit, rinisi kolonizimi me

themelimin e Bononisë (Bologna-s), të *Mutina-s*

(Modena) dhe *Parma-s*.

Për të lidhur kolonitë romake nisi krijimi i një

aksi të vetëm rrugor që u realizua nga konsulli Emilio

Lepido. Rruga Emilia, e cila fillon në Rimini e përfundon në

Piacenza, u kthye në elementin që sillte një transformim

tërësor si në peizazhin ashtu edhe në ekonominë e këtij

territori: u bonifikuan tokat moçalike, u ndanë tokat e

kultivueshme, u krijuan furra pjekjeje për ndërtimin e

qyteteve.

Nga shekulli i parë para Krishtit dhe me perandorin August, falë territorit të saj luginor, Ravenna u kthye në bazën e flotës romake të Lindjes (classis, nga ku vjen edhe emri Classe, vendi ku ndodhej porti i qytetit). Për rrjedhojë, këtu u dyndën shumë marinarë të rekrutuar edhe në toka shumë të largëta. Shumë rrugë u ndërtuan drejt veriut në vazhdim të rrugës Emilia. Themelore, për vetë mundësitë e komunikimit që ofronte, edhe hyrja e brendshme për në lagunë: përmes sipërfaqeve kënetore bregdetare, ky itinerar bashkonte Ravennan me Altino-n dhe Aquileia-n (që ndodhen në Veneto-n dhe Friuli Venezia Giulia-n e sotme). Romakëzimi solli një shpërngulje sistematike popujsh: një gjurmë të qartë të këtij procesi e gjejmë në shprehjen e fetarisë dhe në zhvillimet e alfabetizimit. Gjatë epokës romake, Adriatiku regjistroi hyrjen e shumë kulteve që vinin nga

vendet pranë Lindjes së Afërt, nga të cilët kanë mbetur gjurmë objektesh, mbishkrimesh dhe monumentesh: një shenjtërore e madhe e dedikuar perëndive të lindjes ishte ndërtuar në Sarsina, në zemër të Apeninit mbi Cesena.

Në shekullin V dhe VI pas Krishtit, Ravenna u kthye në qendrën politike



PËR TË LIDHUR KOLONITË
ROMAKE U KRIJUA NJË AKS I VETËM
RRUGOR QË U REALIZUA NGA KONSULLI EMILIO
LEPIDO. RRUGA EMILIA, E CILA FILLON NË RIMINI E
PËRFUNDON NË PIACENZA, U KTHYE NË ELEMENTIN QË
SILLTE NJË TRANSFORMIM TËRËSOR SI NË PEIZAZHIN ASHTU
EDHE NË EKONOMINË E KËTIJ TERRITORI: U BONIFIKUAN
TOKAT MOÇALIKE, U NDANË TOKAT E KULTIVUESHME,
U KRIJUAN FURRA PJEKJEJE PËR NDËRTIMIN
E QYTETEVE.





NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfëhet



kryesore të gadishullit: që në vitin 402, perandori Onorio kishte vendosur atje kryeqytetin e perandorisë romake. Pas periudhës së rrëmujshme të pushtimeve barbare, në vitin 493, Italia kaloi nën sundimin e ostrogotëve dhe në Ravenna u vendos mbreti i tyre, Teodoriku. Në vitin 527, me ardhjen e perandorit bizantin Justinian, Ravenna u kthye në qendrën e guvernatorit të Italisë (Esarku) dhe pati atje një periudhë të shkëlqyer, çka e dëshmojnë edhe bazilikat e san Vitale-s dhe sant Apolineare në Classe.

Në vijim të shekullit VI, uniteti politik i rajonit u shpërbë nga pushtimi i longobardëve, të cilët zunë territore të ndryshme por nuk arritën t'i mposhtnin përfundimisht bizantinët.

Longobardët pushtuan Emilia-n deri në Bologna dhe Imola, dhe u përqendruan në Reggio; bizantinëve u mbeti zona e Adriatikut që u quajt Romagna, për arsye se i përkiste romakëve të Bisanzio-s.

Kundër longobardëve, Papa kërkoi ndihmën e frankëve,

të cilët zbritën në Itali dhe në vitin 773 i mundën. Territoret e rajonit tonë u bënë pjesë e Perandorisë së Shenjtë Romake, të themeluar me kurorëzimin e mbretit frank Karli i Madh, në vitin 800.

Gjatë shekujve të parë të Mesjetës, në manastiret dhe abacitë e mëdha, dorëshkruesit rikopjuan tekstet e traditës klasike, siç ndodhi për një kohë të gjatë në Bibbio,





në Apeninin piacentin. Vepra e atyre duarve kontribuoi në lindjen e bibliotekave të mëdha: ndër të parat ishte Malatestiana e Cesena-s. Zhvillimi i mëtejshëm i perandorisë çoi në ndarjen administrative të territoreve në çifligje. Me kalimin e kohës, sovraniteti i çifligjeve ra në duart e peshkopëve, të cilët filluan kështu të ngrenë zotërime të vogla lokale. Në këtë periudhë, në rajon u krijuan dy pole me një ndikim mjaft të madh: në Emilian perëndimore ishte zotërimi i shtëpisë së Canossa-s (protagoniste ishte kontesha Matilde); ndërsa territori romanjol u organizua nën sovranitetin e kryepeshkopit të Ravenna-s. Perandoria dhe kisha u gjendën të kundërvënë në “luftën për emërim”, që do të thotë për të drejtën e emërimit të peshkopëve.



Pikërisht mbi kodrën pranë kështjellës së

Canossa-s ndodhi edhe poshtërimi i perandorit Enriku IV përpara papës Gregorio VII (1077).

Në këtë kontekst, shtresat më të pasura të qytetit (pronarët e tokave dhe tregtarët) shfaqën padurimin e tyre kundrejt fuqive feudale dhe promovuan një rregull të ri politik që kishte për synim të administronte në nivel lokal ligjet, drejtësinë, taksat, ekonominë: Komunën. Mes shekujve XI dhe XII, në qendrat emiliano-romanjole, si në gjithë Italinë veriore, u formuan qeveri të







NË VITIN 527, ME ARDHJEN
NË FUQI TË PERANDORIT BIZANTIN
JUSTINIAN, RAVENNA U KTHYE NË QENDRËN
E GUVERNATORIT TË ITALISË (ESARKU)
DHE JETOI NJË PERIUDHË TË SHKËLQYER, ÇKA E
DËSHMOJNË EDHE BAZILIKAT E SAN VITALES
DHE SANT APOLINARE NË CLASSE.

NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfëhet



reja, të udhëhequra nga konsuj të zgjedhur nga një këshill qytetarësh, që shtrinë në mënyrë progresive ndikimin e tyre politik dhe ekonomik në territoret përreth. Me përhapjen e modelit komunal, qytetet u kthyen në qendra të një rilindjeje ekonomike dhe kulturore.

Fillimisht, duke krijuar aleanca me njëra-tjetrën, komunat garantonin pavarësinë e tyre nga sulmet e trupave perandorake. Por pasi mposhtej komuna armike, lindnin rivalitetet midis qyteteve të afërta me njëra-tjetrën dhe kundërshti të brendshme midis fraksioneve në qytete: palët në luftë ishin ose me Papatin (guelfët) ose me Perandorin (gibelinët). Luftërat e vazhdueshme civile dobësuan magjistraturat komunale dhe përgatitën terrenin për krijimin e qeverive personale, në duart e familjeve fisnike. Në gjithë qytetet emilio-romanjole u konsoliduan kështu sinjoritë (principatat): Piacenza, Parma, Mirandola, Carpi, Correggio, Scandiano, Imola, Faenza, Forli, Ravenna, Rimini. Që prej vitit 1242, Ferrara në veçanti u kthye në qendrën e sinjorisë së Estensëve, e cila më pas përfshiu edhe Modenan dhe Reggio-n. Në Bolonjë, regjimi komunal pati jetëgjatësi më të madhe dhe sinjoria e Pepoli-ve e më pas ajo e Bentivoglio-ve u shfaqën për periudha të shkurtra. Pas një sërë luftërash mes fuqive rajonale fqinje (Milano, Venezia, Firenze, la Santa Sede [Selia e Shenjtë]), në fillim të viteve 500, Bologna dhe Romagna u bënë pjesë e Stato Pontificio (Shtetit Papnor).

Pavarësisht nga luftërat dhe paqëndrueshmëritë politike,

gjatë epokës së komunave dhe sinjorive u zhvilluan me gjallëri dhe larmi të madhe jeta kulturore dhe ekonomike, industria, bujqësia, tregtia, arti, poezia: në qytetin e Ravenna-s ruhet edhe sot e kësaj dite trupi i Dante Alighierit. Në këtë periudhë lindi dhe u bë i njohur Universiteti i Bologna-s, i cili është më i vjetri në botë. U ndërtuan gjithashtu katedralet, pallatet komunale, kështjellat dhe fortesat, ndërsa muret e qytetit u zgjeruan gjithmonë e më shumë për të përballuar numrin gjithnjë e në rritje të banorëve.

Vitet 500 u hapën me konsolidimin e sundimit papnor në pjesën lindore të rajonit. Papa Giulio II, me një sërë sulmesh ushtarake, pushtoi fillimisht qytetet e Romagna-s e më pas, në vitin 1506, Bologna-n. Në fund të shekullit, në vitin 1597, vdiq duka Alfonso d'Este, pa lënë trashëgimtarë të drejtpërdrejtë: Shteti Papnor pushtoi Ferrara-n dhe territorin e saj, ndërsa nën zotërimin e estensëve mbeti Modena dhe Reggio. Në këtë mënyrë u stabilizua Emilia-Romagna, një sistem politik i destinuar të jetonte gjatë, me përjashtimin e vetëm të periudhës së Napoleonit, deri në Bashkimin e Italisë; territori rajonal u nënnda në tre shtete: dukati i Parmës dhe Piacenzas (i krijuar në vitin 1545 nga papa Paolo III për familjen e tij: Farnesët), dukati i Modenas dhe zotërimet e Shtetit Papnor (Bologna, Ferrara, Romagna).

Ndër personazhet e mëdhenj të kulturës që lanë gjurmë në





GJATË SHEKIJVE TË PARË
TË MESJETËS, NË MANASTIRET DHE
ABACITË E MËDHA, DORËSHKRUESIT RIKOPJUAN
TEKSTET E TRADITËS KLASIKE, SIÇ NDODHI PËR NJË
KOHË TË GJATË NË BOBBIO, NË APENININ PIACENTIN.
VEPRA E ATYRE DUARVE KONTRIBUOI NË LINDJEN E
BIBLIOTEKAVE TË MËDHA: NDËR TË PARAT ISHTE
MALATESTIANA E CESENA-S.




NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfëhet



Romagna gjatë periudhës së Rilindjes, ishte domethënëse prania e Leonardo da Vincit, i cili në vitin 1502 hartoi projektin e porto-kanalit të Cesanaticos. Megjithë stabilitetin politik, shekujt XVI, XVII dhe XVIII njohën vetëm periudha të shkurtra paqeje. Më pas, rajoni u përshkua nga ushtritë e huaja, që sillnin me vete epidemi të ndryshme dhe uri: pushtimi i lancikenekëve, lufta tridhjetë vjeçare, luftërat për zgjerim territori në mesin e viteve 700. Në provincat e Shtetit Papnor u përforcua edhe më shumë struktura administrative qendrore: si rrjedhojë, lindi fuqia e përfaqësuesve të Papës, kardinalët “e lidhur”, nga vjen dhe fjala “Legatë” për territoret e Bolonjës, Ferraras dhe Ravenna-s. Nga ana tjetër, dukatet e vogla të Parma-s dhe Modena-s, përdorën diplomacinë për të mbijetuar mes fuqive më të mëdha.



Gjatë viteve 600 u restauruan ndërtesat dhe u zbukuruan qytete të reja dukale: në vitin 1617, në Parma, Ranuccio I Farnese i besoi Giovan Battista Aleotti-t ndërtimin e teatrit të drunjtë në Palazzo della Pilotta, një skenë ideale e skenografive baroke; në vitin 1634, në Modena, Francesco I d'Este ndërtoi Pallatin dukal me qëllim ruajtjen e koleksionit të tij të mrekullueshëm të veprave të artit. Në gjysmën e dytë të viteve 700, edhe në rajonin tonë

filluan të përhapen idetë e Iluminizmit si dhe përpjekjet për të përballur me një qëndrim laik dhe racional problemet sociale, politike dhe ekonomike. Mbi të gjithë, dukati i Parmës, i cili i kaloi në vitin 1732 dinastisë franceze të Borbonëve, dukej i ndjeshëm ndaj ndikimeve kulturore evropiane, të cilat në politikë u përkthyen në luftë kundër abuzimeve dhe privilegjeve klerikale, dhe në ekonomi si modernizim i industrisë së mëndafshit, të letrës dhe të shtypit (në Parma ishte mjaft aktiv tipografi Giambattista Bodoni). Në Modena, shumë intelektualë, ndër të cilët Ludovico Antonio Muratori, morën pjesë drejtpërsëdrejti në zbatimin e reformave në fushën e drejtësisë dhe të tatimeve.

Kur filloi sulmi i Napoleonit në Itali, parimet e barazisë, të përcjella nga Revolucioni francez, ishin mjaft të përhapura në rajonin tonë, madje edhe mes shtresave popullore që frymëzoheshin nga qëndrimet më radikale të jakobinëve. Pas pushtimit ushtarak të Napoleonit në vitin 1796, në Bologna, Ferrara, Modena dhe Reggio u formuan qeveri të përkohshme, të cilat bënë reforma të thella kundër privilegjeve feudale dhe fisnike.

Nga bashkimi i këtyre katër qyteteve lindi Republika Cispadana, e cila në kongresin e Reggio-s, më 7 Janar 1797, shpalli si simbol të saj tringjyrëshin e gjelbër, të bardhë dhe të kuq: flamuri i ardhshëm i Italisë.

Pak muaj më vonë, me dëshirën e Napoleonit, Republika Cispadana u bë pjesë e Republikës së re Cisalpina, e cila



NDËR PERSONAZHET E MËDHENJ
TË KULTURËS QË LANË GJURMË NË
ROMAGNA GJATË PERIUDHËS SË RILINDJES,
ISHTË DOMETHËNËSE PRANIA E LEONARDO DA
VINCIT, I CILI NË VITIN 1502 HARTOI PROJEKTIN
E PORTO-KANALIT TË CESANATICO-S.



Handwritten text at the top left, possibly a title or header, including the words "Handwritten text" and "Handwritten text".

Handwritten text in the upper right quadrant, including the words "Handwritten text" and "Handwritten text".



Handwritten text at the bottom left, including the words "Handwritten text" and "Handwritten text".

NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfëhet



shtrihej në gjithë veriun e vendit dhe që më pas do të quhej Republika e Italisë.

Në vitin 1805, Republika u kthye në Mbretëri të Italisë, mbreti i së cilës ishte Napoleon Bonaparti. Ndërsa Parma dhe Piacenza u aneksuan menjëherë nga Franca.

Pas momenteve të para të entuziazmit për valën revolucionare, tek popullata italiane lindi një armiqësi e fortë kundrejt francezëve, të cilët faktikisht kishin nën kontroll Republikën dhe më pas Mbretërinë e Italisë. Pesha e tatimeve, rekrutimi i detyrueshëm ushtarak, gjendja e vazhdueshme e luftës krijonin pakënaqësi në gjithë shtresat sociale. Kështu filloi të lindte ideja e një revolte popullore për pavarësinë dhe bashkimin e Italisë, siç thuhet edhe në deklaratën e Rimini-t të Gioacchino Murat (ishte 30 marsi i vitit 1815). Por Kongresi i Vienës rivendosi sistemin politik të periudhës para Napoleonit dhe e vendosi Italinë nën kontrollin austriak, duke e shtyrë për dhjetëvjeçarët e mëpashëm rezultatin e aspiratave patriotike.

Gjatë viteve 1814 dhe 1815, edhe në territorin emilian, Kongresi i Vienës rivendosi rendin antik, duke ia kthyer Legatat (Bologna-n, Ferrara-n, Forli-n dhe Ravenna-n) Shtetit Papnor, Modena-n estensëve dhe Parma-n ish perandoreshës së Austrisë, Maria Luigia. Por pakënaqësia vazhdonte të përhapej, veçanërisht ndër ata që kishin pasur një rol politik të rëndësishëm në periudhën




e Napoleonit ose që kishin përfituar avantazhe ekonomike nga hapja e kufijve dhe nga zhvillimi i tregtisë në zonën padane e që tani penalizoheshin sërish. Për të shprehur më fort këtë pakënaqësi, lindën një sërë shoqatash pak a shumë të fshehta.

Vala e kryengritjeve që u përhap nga Franca në shumë pjesë të Evropës në vitin 1831, e pati pikënisjen e saj në Modena, me Ciro Menottin: që këtej kryengritja pati jehonë dhe në Parma e në Legata. Ndërhyrja e trupave austriake e rivendosi edhe njëherë rendin, edhe pse në Modena dhe në Legata pati reagime të rënda. Edhe revolucioni i vitit 1848 e përfshiu Emilian: Dukatet u ngritën dhe falë ndërhyrjeve popullore, i detyruan princat t'ia mbathnin dhe shpallën aneksimin e Mbretërisë së Sardegnas. Ndërkohë në Romë po shpallej Republika, Shteti Papnor njohu kushtetutën në Bologna, në Ferrara dhe në Romagna, por duke u mohuar nga ana tjetër pjesëmarrjen në luftë kundër austriakëve, të cilët në këtë mënyrë e morën sërish nën kontroll. Rënia e Republikës Romake dhe tërheqja e Garibaldit në Luginat e Comacchio-s shënuan përfundimin e kësaj ngjarjeje epike.

Në maj të vitit 1859, kur trupat aleate të Napoleonit III dhe të mbretit të Sardenjës, Viktor Emanuelit II, e kaluan Ticinon, u përsërit kryengritja kundër austriakëve, me përfshirjen me shtresës së re borgjeze. Plebishitet (referendumet) e marsit të vitit 1860 sanksionuan







ËNJATË SHEKULLIT TË XVII
U RESTAURUAN NDËRTESAT DHE
U ZBUKURUAN KRYEQYTETET E REJA TE
"DUKATAVE: NË VITIN 1617, NË PARMA, RANUCCIO I
FARNESE I BESOI GIOVAN BATTISTA ALEOTTI NDE
RTIMIN E TEATRIT TË DRUNJTË NË PALAZZO
DELLA PILOTTA, NJË SKENË IDEALE E
SKENOGRAFIVE BAROKE.

NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfëhet



aneksimin e tetë provincave të reja nga Mbretëria sarde. Zgjedhjet e para të përgjithshme të asaj që më vonë do të bëhej Mbretëria e Italisë, u zhvilluan në janar të vitit 1860: patriotët më në zë dhe shumë personalitete të rajonit hynë dhe u bënë pjesë e parlamentit. Ndër ta ishte dhe bolonjezi Marco Minghetti, i cili mbështeste decentralizimin, si një kundërpeshë e nevojshme për bashkimin e provincave; ai hartoi një model të lokalizmit rajonal që hasi kundërshti të forta nga ana e shtresës së re drejtuese.

Në mes të shekullit që kaloi nga aneksimi e deri në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, ndarja shekullore e vendit me legjislacione të ndryshme, situatat kontrastuese ekonomike dhe rishfaqja e rivaliteteve mes bashkive e vështirësuan shumë asimilimin e provincave emiliano-romanjole në Italinë e bashkuar. Megjithatë, periudha midis viteve 1870 dhe 1914 u karakterizua nga një zhvillim i madh ekonomik, një përparim i bujqësisë, fillimi i veprave të mëdha të bonifikimit, ngritja e industrive moderne dhe aktivizimi i tregtisë. Emilia dhe Romagna ishin skena të një shtyse të fortë drejt organizimit në shoqata, me macinianët dhe socialistët e drejtuar nga Andrea Costa. U formuan kooperativat e para bujqësore për qiradhënie kolektive dhe kooperativat e para të mëditësve. Luftërat sociale dhe çështja rurale ishin për një kohë të gjatë protagoniste të jetës së brendshme politike: në vitin 1897 u zhvilluan greva e harëseve të orizoreve në Ferrarese dhe greva e korrëseve në Molinella; në vitin 1901, në Bolonjë u mbajt kongresi i

parë i Federatës së punonjësve të tokës; në vitin 1907 u zhvilluan greva bujqësore të ashpra dhe në vitin 1908 edhe në provincat e Ferrarës, Bolonjës dhe Parmës.

Në fund të Luftës së Madhe, në Emilia-Romagna problemet e punonjësve të tokave dolën sërish në pah më të thella se kurrë. Niveli i jetesës në fshatra, i përmirësuar pas vite luftërash të ashpra, solli një rritje të konsiderueshme të popullsisë rurale dhe një shtim tej mase të fuqisë punëtore, që vinte si rrjedhojë e përhapjes së ulët të industrisë në rajon. Në gjithë Italinë, përpjekjet e organizatave socialiste rifituan fuqinë e tyre në qytete dhe në fshatra, e madje edhe në valën e revolucionit rus: miliona punëtorë, fshatarë dhe të papunë u përfshinë në greva dhe trazira, me Emilia-n në pararojë. Dhe pikërisht këtu, reagimi i pronarëve agrarë ishte më i dhunshëm: në Bologna sulmi i 21 nëntorit të vitit 1920 ndaj pallatit d'Accursio, i hapi rrugë shtimit të dhunës, agresioneve dhe shkatërrimit nga skuadrat fashiste që subvencionoheshin prej tyre. Mijëra punëtorëve emilianë, për t'u shpëtuar persekutimeve, u desh të mërgonin nga vendi i tyre, duke e nxitur ndonjëherë edhe nga jashtë luftën kundër diktaturës së Mussolinit. Në vitet 1936 deri 1939, shumë vullnetarë nga komunat e Emilia-s shkuan në Spanjë dhe luftuan kundër frankizmit.

Beteja të tjera aq të ashpra sa nuk ishin parë që në periudhën e Mesjetës, erdhën deri në rajon gjatë viteve të fundit të Luftës së Dytë Botërore. Nga fundi i korrikut të vitit 1943, forcat e ndryshme të antifashizmit emiliano-



NGA BASHKIMI I
BOLOGNA, FERRARA, MODENA E
REGGIO LINDI REPUBLIKA CISPADANA,
E CILA NË KONGRESIN E REGGIO-S,
MË 7 JANAR 1797, SHPALLI SI SIMBOL
TË SAJ TRINGJYRËSHIN E GJELBËR,
TË BARDHË DHE TË KUQ: FLAMURI
I ARDHSHËM ITALIAN.





NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfëhet



romanjoli u angazhuan gjithmonë e më shumë në aksionet e shqetësimit dhe rezistencës kundër ushtrisë pushtuese naziste. Në këto rrethana, forcat e ndryshme sociale dhe politike ditën të bashkëpunonin dhe përfshirja në gjithë këtë e një pjese të madhe të popullsisë, si në fshatra ashtu edhe në qytete, i dha Rezistencës një karakter popullor si asnjëherë tjetër në historinë e Italisë. Në vjeshtën e vitit 1943 datojnë aksionet e para luftëtare partizane, të cilat u shtuan gjatë dy viteve pasues përgjatë gjithë vargmalit apenin të ndarë nga fronti gotik, i përgatitur nga gjermanët përgjatë 300 kilometrave nga Rimini në La Spezia. Shtypja gjermane goditi fort partizanët, popullsinë civile dhe klerin lokal për mbështetjen që i jepnin Rezistencës: 3.500 ishin civilët e pushkatuar ose të masakruar në rajon, 6.000 ishin partizanët e rënë. Një plagë, shenjat e së cilës vazhdon t'i mbajë një rajon i tërë dhe që në shumë vende nuk është mbyllur akoma, siç është rasti i vrasjeve në masë të grave, pleqve dhe fëmijëve nga trupat SS në Luginën e Reno-s. Aleatët hynë në Rimini në shtator të vitit 1944 dhe në nëntor në Ravenna. Pas pezullimit të gjatë dimëror të përparimit të trupave, në prill aleatët nisën sulmin përfundimtar, duke filluar shkatërrimin e asaj që kish mbetur nga fronti gotik, në drejtim të Bologna-s. Kryengritja nëpër qytete i detyroi të arratisen fashistët e braktisur nga gjermanët.

Nga 14 deri më 28 prill të vitit 1945 u çliruan Imola, Bologna, Modena, Ferrara, Reggio Emilia, Parma dhe



Piacenza: brenda dy javësh, fronti fashist ra nga Senio deri në lumin Po. Kështu filloi një fazë e re e historisë së Emilia-Romagna-s: ajo e konsolidimit, e mbrojtjes dhe zhvillimit të demokracisë.

Shumë luftëra të tjera pasuan, në kundërvënien e thellë mes ideve të rinovimit dhe konservatorizmit, duke i ruajtur të gjalla idetë e Rezistencës për një kohë të gjatë.

Në vitin 1970, për të vendosur rendin e parashikuar në Kushtetutë, që pas Luftës së Dytë Botërore shënoi fundin e monarkisë dhe lindjen e Republikës italiane, u themelua rajoni i Emilia-Romagna-s. Nga vitet 70 deri në fundin e viteve 900, Rajoni ka administruar dhe zhvilluar një strukturë territoriale të karakterizuar nga policentrizmi që në periudhën e pas luftës: qytete të forta, të afta për të ndërthurur dhe integruar rritjen ekonomike, me zhvillimin social dhe efikasitetin administrativ. Një model organizativ që gjatë viteve u ka lejuar komuniteteve lokale të shprehin, shembuj nga origjina kulturore dhe qytetare. Territoret e Emilia-Romagna-s nuk kanë të gjithë të njëjtat karakteristika ekonomike dhe sociale, por ky është rajoni italian me dallimin më të vogël midis provincës më të dobët dhe asaj më të fortë, dhe çdo rreth, sipas veçorive të tij, ka qenë protagonist i proceseve zhvilluese. Aksi i rrugës Emilia u konsolidua nga Bologna deri në Rimini; brezi bregdetar u zhvillua si në jug, në pjesën me dendësi më të madhe banorësh, ashtu edhe në veri, në pjesën me vlera më të mëdha natyraliste. U përforcua aksi





NGA 14 DERI 28 PRILL TË VITIT 1945
U ÇLIRUAN IMOLA, BOLOGNA, MODENA,
FERRARA, REGGIO EMILIA, PARMA DHE PIACENZA:
PAS DY JAVËSH, FRONTI FASHIST RA NGA SENIO
DERI NË LUMIN PO. KËSHTU FILLOI NJË FAZË E RE
E HISTORISË SË EMILIA-ROMAGNA-S: AJO E
KONSOLIDIMIT, E MBROJTJES DHE ZHVILLIMIT
TË DEMOKRACISË...



NËNTË HAPA NËPËR HISTORI

Emilia-Romagna rrëfëhet




pedemontan nga Parma deri në Bologna dhe rryma të reja produktive përshkojnë ultësirën: trekëndëshi Imola-Faenza-Lugo, zona e Mirandola-s, boshti Bologna-Ferrara, zonat disi më të thella të Rimitit. Zonat e Apenineve, të cilat përfaqësojnë pothuajse gjysmën e territorit rajonal, janë vlerësuar për specifikat e ndryshme lokale dhe secila prej tyre ka gjetur rrugën e saj të zhvillimit.

Sot, Emilia-Romagna është një rajon i madh evropian, një nyje strategjike midis zonave të forta të Evropës veriqendrore, gjirit të Mesdheut dhe zonës Adriatik-Danub. Ndërkohë që sfera bujqësore ndjen ende rrjedhojat e një krize strukturore, sektori i prodhimeve industriale të specializuara është shumë i gjerë dhe konkurrues, veçanërisht në fushën e mekanikës. Sektori më dinamik i shërbimeve është ai i shërbimeve për ndërmarrjet, i cili është mjaft i përhapur në territor dhe në raport me popullsinë, rendit në vendet e para në nivel kombëtar shumë provinca (Bologna, Parma, Modena dhe Reggio). Turizmi vazhdon të përfaqësojë një segment të rëndësishëm të ekonomisë rajonale. Vlera e investimeve dhe numri i atyre që merren me kërkim shkencor dhe teknologjik janë ndër më të lartët në Itali dhe sistemi i universiteteve rajonale renditet në vend të parë për sa i përket thithjes së studentëve nga jashtë. Shërbimet sociale, shëndetësia, tokat dhe aktivitetet kulturore, bizneset e shërbimit janë në tërësinë e tyre në pararojë.

Stema e përdorur nga Rajoni Emilia-Romagna përfaqëson në mënyrë të stilizuar dy aspekte thelbësore të historisë së gjatë të këtij territori: vijën e gjarpëruar të lumit Po dhe atë pjerrët të rrugës Emilia. Elementi natyror i ujit që shkon drejt detit dhe ai njerëzor i rrugës që lidh njerëzit, me punën, pasionet dhe historitë e tyre.





 Regione Emilia-Romagna

Ç'HISTORI
E MADHE PËR T'U
TREGUAR!

Realizimi tipografik nën kujdesin e
Qendrës së Shtypit të rajonit Emilia-Romagna

Doli nga shtypi në

Dhjetor 2009





 Regione Emilia-Romagna

ibc istituto per i beni artistici
culturali e naturali